

VENDIM
Nr.30, datë 8.12.2009

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAU, PESHKOPI

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për SHAU, Peshkopi si më poshtë:

Për ujin e pijshëm:

Konsumator familjar (lidhje në banesë)	27 lekë/m ³ ;
Konsumatorë familjare (çezma publike)	24 lekë/m ³ ;
Institucione buxhetore	65 lekë/m ³ ;
Ente private	85 lekë/m ³ .

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi